




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 17.08.2022

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 68 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 17, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 183 të datës 04.08.2022, bën këtë:

NJOFTIM PËR PJESËMARRJE NË DISKUTIM PUBLIK

Njoftohen qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës Kompanitë e ndërtimit dhe të gjithë të interesuarit e tjerë, se diskutimi publik është i hapur nga data 17.08.2022-30.08.2022 për: “Propozimin për shqyrtimin e Projekt-Rregullores Komunale për bonuese të zonimit për ndërtime në Fushë-Kosovës”.

Për sqarime dhe konsultime tjera, lidhur me ‘Propozimin për shqyrtimin e Projekt-Rregullores Komunale për bonuese të zonimit për ndërtime në Fushë-Kosovës’, mund të drejtoheni në ndërtesën e Komunës së Fushë-Kosovës, te Drejtoria e Planifikimit Urban kati përdhesë, Zyra e Kuvendit kati përdhesë dhe Zyra për Informim Publik, kati i parë.

Takimi për konsultim publik do të mbahet më datën: **24.08.2022, në orën 10:00h**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në ndërtesën e Komunës. Njoftimi për diskutim publik publikohet në ueb-faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.


Një takim dhe diskutime konsultuese do të mbahet edhe me ‘Kompanitë e ndërtimit’, me datën **25.08.2022 në orën 10:00h**, në sallën e Kuvendit të Komunës në Fushë-Kosovë.

Përshëndetje!





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 04.08.2022

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 29.07.2022, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 272, të datës 15.07.2022, të paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, i shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafiu 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 39, të Udhëzimit Administrativ Nr. 24/2015, mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores Komunale për bonuse të zonimit për ndërtime në Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores Komunale për bonuse të zonimit për ndërtime në Fushë-Kosovës.
2. Projekt-Rregullorja Komunale për bonuse të zonimit për ndërtime në Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, cakton lejimin me stimulime në emër të kompenzimit të interesit publikë, për lirim të sipërfaqeve për objektet dhe infrastrukturën publike.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullorja Komunale për bonuse të zonimit për ndërtime në Fushë-Kosovës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe mbajtjen e diskutimit publikë, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Planifikimit Urban.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU dhe Arkivës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

05 Nr: 400
Dt. 14.07.2022

Për /Za/To:	KUVENDIN KOMUNAL TË FUSHË KOSOVËS
Përmes:	<i>14</i> Kryetarit të Komunës: z. Burim Berisha
Nga/od/from:	Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban Dr. sc. Abdullah Prebreza
Tema/Subjekti/ Subjek	PROPOZIM PËR PROJEKT RREGULLORE KOMUNALE PËR BONUS TË ZONIMIT

Bazuar në Ligjin 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, ligjit të ndërtimit 04/L-110 dhe nenit 39 të UA 24/2015, Vendimit nr.100 të dt:05.08.2020 i HZK- Fushë Kosovë viti 2020-2028 dhe Vendimit të Grupit Punues nr:273 dt:11.05.2022 Drejtoria e Planifikimit Urban bënë këtë:

PROPOZIM

PËR PROJEKT RREGULLORE KOMUNALE PËR BONUS TË ZONIMIT

E cila sipas nenit 39 të UA 24/2015, kërkohet për funksionalizim të Hartës Zonale të Komunës së Fushë Kosovës për vitet 2020-2028 që është e miratuar sipas Vendimit nr.100 të dt:05.08.2020.

Me këtë rregullore përcaktohen bonuset e zonimit, përmes të cilave lejohen stimulime në emër të kompensimit të interesit publik për lirim të sipërfaqeve për objektet dhe infrastrukturën publike.

Fusheveprimi i kësaj rregullore përcakton mënyrën e kompensimit të tokës së planifikuar për ndërtim në zonën e lejuar me bonuse të zonimit sipas HZK.

PROJEKT RREGULLORE KOMUNALE PËR BONUSË TË ZONIMIT

Rregulloret komunale permbajne:

- 4.1. pershkrimin e Bonusit te Zonimit qe lejohet;
- 4.2. pershkrimin e strategjive me sqarime se si perfiton komuniteti nga Bonusi i Zonimit qe eshte zgjedhur;
- 4.3. listen e te gjitha llojeve dhe kategorive te perfitimeve te komunitetit qe mund tepranohen nga zhvilluesit;
- 4.4. siperfaqet dhe standardet per zhvillim te perfitirneve publike;
- 4.5. identifikimi sakte i zones ne te cilen Bonuset e Zonimit mund te lejohen;
- 4.6. procedurat per rnarren e nje Bonus Zonimi; dhe
- 4.7. dizpozitat per te siguruar njoftim dhe shqyrtimin publik per projektin e propozuar qe eshte percaktuar sipas Nenit 36 te ketij Udhezimi Administrativ.

PROJEKT RREGULLORE KOMUNALE PËR BONUSET E ZONIMIT

Neni 1 Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen bonuset e zonimit, përmes të cilave lejohen stimulime në emër të kompenzimit të interesit publik për lirim të sipërfaqeve për objektet dhe infrastrukturën publike e po ashtu kjo rregullore do të jetë në përputhje me qëllimet, objektivat, vizionin dhe strategjitë e Pzhk dhe do të përdoret për të:

- rituar hapësirat e hapura ose sipërfaqet e gjelbëruara,
- ofruar përmirësim të trafikut dhe lëvizjeve të këmbësoreve ,
- krijuar sipërfaqe për objekte publike ku mund të zhvillohen projekte për krijimin e hapësirave publike dhe sociale prej të cilave përfiton komuniteti.

Neni 2 Fushëveprimi

Fushëveprimi i kësaj rregullore përcakton mënyrën e kompenzimit të tokës së planifikuar për ndërtim në zonën e lejuar me bonuse të zonimit sipas Hzk.

Procedurat e dhënies së bonuesit, formën e kompenzimit të përshkruara si më poshtë:

1. Zvogëlim të kërkesave për tërheqje të vijave të ndërtimit
2. Zvogëlimi apo lirim nga taksat për leje ndërtimore
3. Zvogëlim të kushtit për sipërfaqen minimale të parceles, gjerësi dhe thellësi.
4. Rritje të lartësisë dhe kateve maksimale të ndërtesës
5. Rritje të dendësisë

Neni 3 PËRKUFIZIMI

Përkufizimet e përdorura në këtë Rregullore janë si më poshtë:

1. Hapësirave publike dhe sociale- janë hapësira në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi mund të jetë publik dhe/ose privat si e:

Parqeve publike dhe hapësirave të hapura;

- Fushave sportive dhe hapësirave rekreative;
- Hapësirave dhe ndërtimet për shërbime mjekësore;
- Ndërtesat për shërbime sociale;
- Ndërtesat e institucioneve parashkollore;
- Shkollat dhe universitetet;
- Qendrat administrative;
- Hapësirat dhe ndërtesat e sigurisë publike;
- Dhe hapësirat hapura:
- Hapësirat e gjelbëruara dhe
- Parqet

2. Hapësira sociale: Ka disa qasje për trajtimin e ndërtimit të brendshëm dhe klasifikimin e pjesëve, e cila përfshin strukturën sociale. Qasja themelore është duke shqyrtuar tre blloqe funksionale synuar:
 - Aktivitetet socio-politike dhe kulturore, e cila përfshin arsimin, shkencën, artin, aktivitete në fushën e medias dhe kulturës.
 - ruajtjen dhe rivendosjen e shëndetit të qytetarëve - shëndetit, sportit, turizmit dhe mbrojtjen e mjedisit.
3. Shërbimet publike - strehim dhe shërbimet komunale, tregtia dhe transporti publik.
4. Bonuset e Zonimit –janë stimulime që jepen nga komuna në këmbim të ofrimit të një përfitimi publik në kuadër të normave teknike të planifikimit hapësinor .
5. Kompenzim-shpronësimi : Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, në funksion të procesit të Ndërtimit që do të realizohet sipas HZK.
6. Stimulime –Përfitimet

Neni 4

(4.1. Përshkrimin e Bonusit të Zonimit)

Bonuset e zonimit janë stimulime që jepen nga komuna në këmbim të ofrimit të një përfitimi publik, brenda normave teknike të planifikimit hapësinor , hartës zonale dhe të planit zhvillimor komunal.

Neni 5

(4.2. Përfitimi i komunitetit nga Bonusi i Zonimit që është zgjedhur)

Nga zona e përzgjedhur për tu aplikuar bonuset e zonimit, komuniteti përfiton shërbime të përgjithëshme sociale që ofrohen për të gjithë banoret e zonës ose lagjës si dhe infrastrukturën përcjellëse publike.

Neni 6

(4.3Lista e të gjitha llojeve dhe kategorive të përfitimeve të komunitetit që mund të pranohen nga zhvilluesit)

Zhvillimi i zonës së planifikuar për ndërtim si dhe për aplikim të bonuseve të zonimit realizohet nga zhvilluesi i projektit me miratim nga organet kompetente komunale në zonat e përcaktuara me këtë rregullore për realizimin e infrastrukturës sociale dhe rrugore në harmoni me planin hapësinor ku zhvillojnë procedurat për vendosjen e objekteve publike si me poshtë :

- Parqet publike dhe sipërfaqet e hapura
- Qendrat administrative
- Objekte shëndetësore dhe sociale
- Objekte shkollore
- Institucione parashkollore
- Përmbajtje rekreative sportive

- Parqe dhe rekreim
- Teater
- Bibliotekë
- Kinema
- Objekte garazhuese mbitokesore
- Objekte me karakter fetar
- Infrastruktura rrugore
- Varrezat.

Neni 7

(4.4. Sipërfaqet dhe standardet për zhvillim të përfitirneve publike)

Sipërfaqet për zhvillim të infrastrukturës rrugore përcaktohen sipas vijes rregullative në bloqe të HZK dhe vijës së parcelës së shqytuar, ndërsa sipërfaqet për zhvillim të interesit Publik mvaret prej mundësisë së dhënë nga Pronarët e pasurive të paluajtshme dhe zhvilluesit-investitorit në funksion të objekteve publike sipas nenit 6.

Neni 8

(4.5 Përcaktimi i zonave ku mund të aplikohen bonuset e zonimit)

Zonat e përcaktuara për bonuset e zonimit për infrastrukturë sociale dhe rrugore janë: në kuadër të blloqeve të ndërtimit të organizuara sipas HZK. Këto zona definojnë me koordinata që janë të caktuara në HZK dhe aplikohen kur palët e interesit (zhvilluesi dhe organi komunal) nënshkruajnë marrëveshje për përfitimin e sakt publik të cilin e merr organi komunal në interes të përgjithshëm publik në këmbim të bonusit.

Bonuset e zonimit përcaktohen mbështetur në koeficientet e ndërtimit për zonat e caktuara sipas HZK dhe vlerësimit të pronës nga Vlerësuesit e licencuar.

Neni 9

(4.6. Procedurat për marrjen e një Bonus Zonimi)

Është e kompetencë e organeve komunale që të lëshojnë informatë nga plani hapësinor për personat fizik ose juridik dhe t'i njoftoj ata se do të ketë procedurë të aplikimit të bonuseve.

1. Paraqitja e kërkesës Njoftim mbi destinimin me dokumentacion:
 - Kopja e planit dhe certifikata e pronësisë më e re se 6muaj.
 - Kopja e letërnjoftimit të pronarit.
2. Pas marrjes së Njoftimit mbi destinimin (me koordinata dhe sipërfaqepronari për vazhdim të procedurës duhet t'a paraqes kërkesën për Kushte Ndërtimore.
3. Në kuadër të Njoftimit Publik të Kushteve Ndërtimore do të paraqitet hapsira dhe sipërfaqja e sakt e shpronësimit.
4. Pas përfundimit të Njoftimit publik, Para pajisjes me kushte ndërtimore komuna do të nënshkruaje një marrëveshje për zhvillim, me qëllim të përcaktimit të bonuseve të sakta që pranon zhvilluesi dhe përfitimin e sakte publik të cilin zhvilluesi ofron në këmbim për këtë bonus.

5. Propozim-Marreveshja për sipërfaqet e trajtuara me bonuse të zoonimit e lidhur në mes të komunës-Kryetarit të komunës dhe zhvilluesit-investitorit do të jetë publike dhe do të publikohet në web faqen zyrtare të komunës për 5 ditë.
6. Marrëveshja definitive do të nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës dhe zhvilluesit-investitorit dhe do të ketë fuqi juridike ekzekutive dhe e cila do të shërbej si bazë juridike për ndryshime kadastrale pranë Drejtorise për Prone Gjeodezi dhe Kadastër.
7. pas plotësimit të dokumentacioneve sipas afateve ligjore mund të procedohet me lëshimin e aktvendimit për caktimn e kushteve ndërtimore.

Neni 10 **(Mënyra e aplikimit për bonuset e zoonimit)**

1. Dhënja e bonuseve të zonimit bëhet në blloqet ku është i përcaktuar koeficienti paraprak për sipërfaqen e ngastrës apo bllokut ndërtimor të investitorit ose grup investuesve që planifikohet për interesat e përgjithshme, në emër të bonusit për lirim të sipërfaqeve për interesa të përgjithëshme publike në dobi të komunitetit.
2. Kompensimit sipas pikës 1 të kësaj Rregulloreje për parcelën që merret për infrastrukturën komunale, metrat që i takojnë sipas koeficientit të paraparë për atë zonë rritet sipas raportit të tregut (çmimi i metrit katrorë për afarizëm dhe çmimi i metrit katrorë të njësis banimore), që i takon sipas ISN vlerësohen sipas vlerësuesit të licencuar.

Neni 11 **Bonuset e Zonimit nënkupton dhenjen e stimulimeve që ipen nga komuna në këmbim të një përfitimi publik.**

- I. Një nga mënyrat e kompensimit të tokës private të planifikuar për interes të përgjithshëm sipas Hartës Zonale të Fushë-Kosovës, të miratuar me vendim të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës nr.100 dhe datë 05.08.2020, të jetë aplikimi i koeficientit të ndërtimit edhe për sipërfaqen e kësaj toke.
- II. Rritja e koeficientit në blloqet ku është i përcaktuar koeficienti paraprak për sipërfaqen e ngastrës apo bllokut ndërtimor të investitorit ose grup investuesve që planifikohet për interesat e përgjithshme, në emër të kompensimit sipas nenit 10 e kësaj rregulloreje, metrat e fituara nga bonus ndërtimi vendosen në pllakën e banimit
- III. BANIMI SOCIAL-njësi banesore që kalon në pronësi komunale
Njësia e re banesore(objekte të përfunduara) të fitohet në raport:
 - Kati i banimit nga etazha 1 deri 3 të vlenë raport $1m^2/2.5m^2$.
 - Kati i banimit nga etazha 4 deri 6 të vlenë raport $1m^2/2.0m^2$.
 - Kati i banimit nga etazha 7 e lartë të vlenë raport $1m^2/1.5m^2$.

Shembull:

-nese merret $1m^2$ e sipërfaqes së njësish banesore (Kati i banimit nga etazha 1 deri 3 të vlenë raport $1m^2/2.5m^2$) ajo të shpronësohet me $2.5m^2$ në pllakat e banimit.

Marreveshja të bëhet sipas pikës nenit 12 pika d).

Përcaktimi i lokacionit, katit, orjentimit të njësish banesore dhe metrat katrorë (m^2) e cakton komisioni i caktuar nga administrata Komunale e Fushë Kosovës.

- IV. Rritja e koeficientit sipas kësaj Rregullore nuk do të aplikohet në indeksin e shfrytëzimit të parcelës –ISN së planifikuar në Hartën Zonale të lagjes përkatëse, por i njëjti do të aplikohet vetëm në rritjen e indeksit të ndërtimit (në etazhitet).

Neni 12

Forma e kompensimit të tokës sipas këtij Propozimi do të aplikohet vetëm në bazë të marrëveshjes me pronarin e tokës apo me të autorizuarin ligjor të pronarit.

- a) Pëlqimi paraprak në mes të komunës dhe pronarit apo të autorizuarit të tij, për formën e kompensimit sipas kësaj Rregulloreje, do të arrihet përmes procedurës së caktimit të Kushteve Ndërtimore të lëshuar nga organi kompetent për punë të urbanizimit.
- b) Nëse kemi dallim të koeficienteve sipas zonave të caktuara me koeficient të ndërtimit, atëherë do të merret për bazë koeficienti më i madh në infrastrukturën e planifikuar për llogaritje (p.sh. nëse kemi dy zona të banimit afër njëra tjetrës me koeficient ZB5 dhe ZB6 atëherë merret koeficienti ZB6 që është më i madh në tërë hapësirën).
- c) Në rast të mospërputhjes së trasës së rrugës të planifikuar dhe asaj egzistuese dhe në rastet kur rruga e planifikuar pamundëson zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinorë për të ofruar mundësi të barabart të zhvillimit për të gjithë qytetarët dhe për të siguruar vazhdimësinë e zhvillimit të ndërtimeve të reja në harmoni me të gjitha kriteret të planifikuara me HZK, forma e aplikimit sipas neni 6 dhe neni 13. i UA 06/2017 MMPH mund të zhvendoset ose të largohet me qëllim të organizimit dhe funksionalizimit të tijë.
- d) Marrëveshja definitive për formën e kompensimit sipas kësaj rregulloreje do të nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës dhe Bashkë-investitorëve (investitorit dhe Pronarëve sipas kontratës) dhe të ekzekutohet nga Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronës, e cila marrëveshje do të ketë fuqi juridike ekzekutive dhe e cila do të shërbejë si bazë juridike për ndryshime në aparatin kadastral.
- e) Veprimet juridike nga a,b,c,d e këtij neni 12 e kësaj rregulloreje, do të kryhen në procedurën e lëshimit të Kushteve Ndërtimore, por gjithmonë para përfundimit të procedurës për pajisje me Leje Ndërtimore.
- f) Indeksi i shfrytëzimit të parceles kadastrale zhvillimore ISHPKZH-për zona me destinim banim kolektiv ZB-4, ZB-5, ZB6, ZB-7 do të jetë 35%.
- g) Në të gjitha zonat ndërtesat e banimit kolektiv përbajtjet afariste mund të projektohen në katin perdhesë dhe në katin e parë.
- h) Në rastin kur metrat katrorë të fituara nga bonus ndërtimi nuk mund të vendosen-realizohen të të gjitha në bllokun e ndërtimit sipas marrëveshjes, ato metra vendosen në blloqet tjera ndërtuese nga i njëjti investitor por pa përfshirjen e pronarëve të atij bllokut ndërtues që vendosen.
- i) Për sipërfaqet nëntosore të parcelës(SNP-bodrumi), Vija ndërtimore nëntoksore nga ana fqinjësore (jo nga rruga publike) mund të jetë me distancë min 1m por niveli i dyshemese bodrum-perdhesë të ketë kuoten absolute 0,00m, ndërsa nga Rruga Publike ta ketë distancën min 3m me vijën rregullative.

- j) Billoqet Ndërtimore sipas HZK , në të cilat janë zhvillimet jo konforme me gjendjen ekzistuese mund të bëhet zhvendosja e rrugeve sekondare ose heqja e tyre, me qëllim të organizimit dhe funksionalizimit të tijë.
- k) Parcelat ndërtimore që kërkojnë shqyrtim e të cilat janë me sipërfaqe më të vogël se sipërfaqja e caktuar me norma të HZK, e që nuk mund të bëjë bashkëpunim me parcelat fqinje, shqyrtohet me të gjitha normat tjera.
- l) Në billoqet e ndërtimit me të cilat kanë për destinim afarizëm sipas HZK mund të ndërtohen objekte të përkohëshme P+0 me materjal ndërtimor të përkohëshëm sipas Rregullorës për Objekte të përkohëshme sipas normave të caktuara të UA 08/2017.

Neni 13 **Zbatueshmëria**

Kjo Rregullore është e zbatueshme sipas planifikimit të HZK dhe bazuar në të thënat e përmendura rezulton se aplikimi i kësaj

Neni 14 **Implementimi dhe Mbikëqyrja**

Për implementim të kësaj Rregullore përgjegjëse do të jenë (*Drejtoria e Planifikimit Urban, Marrveshja me Kryetarit dhe Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronës*)

Neni 15 **Pajtuueshmëria me Ligjin**

Bazuar në të thënat e përmendura rezulton se aplikimi i kësaj forme të kompensimit është me interes të shumëfishtë për komunën, andaj edhe sipas nenit 39 të Ua 24/2015 u vendos të bëhet ky Propozim për Projkt Rregullore Komunale për Bonuse të Zonimit në Kuvendin Komunal të Komunës së Fushë Kosovës.

Neni 16 **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Komuna e Fushë Kosovës [____, ____, 2022.]

Kryetari i Kuvendit Komunal

Ali Ismajli